



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punimje/Profuto Received/Delivery	22.09.2023	5	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
MBIKËQYRËS	6206/2023		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1122/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrë për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi – Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, sipas ankesës A. Nr. 1122/2023, të datës 29.08.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Peja, kundër organit të punësimit: Komuna e Pejës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1122/2023, të datës 29.08.2023, të parashtruar nga ankuesi,

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 29.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës Nr.01-016/01-46670/2023 të datës 13.07.2023, për shqiptimin e masës disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit të Punës, Kontratës së Punës, dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi , **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Pejës dhe së i njëjti sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar Nr.02-112-91653, të datës 05.08.2015, të lidhur në bazë të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, është i emëruar dhe ushtron pozitën e punës vozitës - mirëmbajtës.



Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 të këtij ligji, është përcaktuar se: "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. *nëpunësi i Shërbimit Civil* (në tekstin në vijim: *nëpunësi civil*); 2.2. *nëpunësi i Shërbimit Publik*; 2.3. *nëpunësi i Kabinetit*; dhe 2.4. *nëpunësi administrativ dhe mbështetës*.... . 3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë,6. **Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike...**" rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës se ankuesit Nr.02-112-91653 të datës 05.08.2015, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita *Vozitës –mirëmbajtës*, hynë në kategorinë e nëpunësve administrativ-teknik dhe mbështetës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, ve në pah faktin se nëpunësi administrativ-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, andaj, pas konstatimi se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit –bazuar në nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1122/2023 të datës 29.08.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet se ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës, pra, ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës së brendshme, pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e ushtrimit të padisë në gjykatë të rregullt.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër këtij vendimi të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1122/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Hayhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personetit në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.